

URDHËR
Nr. 1, datë 7.1.2015

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 19, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikave 2, 8, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “dh”, “e”, “ë”, të nenit 8, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të institucionit, për Kuvendin e Shqipërisë, nëpunësit autorizues, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, znj. Albana Shtylla.
2. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, për Kuvendin e Shqipërisë, Sekretarit të Përgjithshëm të këtij institucioni, znj. Albana Shtylla për procedurat e prokurimit mbi vlerën e ulët monetare. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor, për Kuvendin e Shqipërisë, drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Administrativ të këtij institucioni, znj. Etleva Zeqo për procedurat e prokurimit nën vlerën e ulët monetare.
3. Kompetencat e deleguara të titullarit të Kuvendit të Shqipërisë, do të ushtrohen për periudhën 1.2.2015, deri më 31.12.2015.
4. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm.
5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta